



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 09 Maj 2021

Nr. 388

**VENDIM**

**Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 3932 prot., datë 19.04.2021 përcjellë nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë

**Kërkues:** Qytetar

**Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23,60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

**I**

**Vlerësimi paraprak**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1380 prot., datë 16.04.2021, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3930 prot., datë 19.04.2021 nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sekretari i Përgjithshëm zj. Ornela Zonja,



Data: 09 Maj 2021  
Nr. 388

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 3930 prot., datë 19.04.2021 përcjellë nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

është përcjellë denoncimi i mbërritur nëpërmjet e-mail pranë këtij institucioni nga një person anonim. Bashkangjitur denoncimit të kërkuesit është paraqitur e-mail ku pretendohet se: *“Persona të afërt të ish- ministrit Xhafa, marrin informacion në terren për individë të cilët jetojnë jashtë vendit dhe nëse këta individë do të marrin pjesë në zgjedhjet e 25 Prillit apo jo. Këtë informacion qytetari pretendon se , këta persona do ta përdorin për të manipuluar votimin elektronik, pra edhe nëse këta qytetarë të cilët jetojnë jashtë shtetit nuk do të marrin pjesë në zgjedhjet e 25 Prillit, ata do të figurojnë në sistemi si votues të Partisë Socialiste.”*

Denoncuesi kërkon verifikimin dhe hetimin e rastit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njuh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Bazuar në nenin 6, pika 4, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht kallëzimin nga denoncuesi, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit, 23 dhe 60 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr.9/2021, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,



## V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative, për shkak se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet dhe për shkak të mungesës së kompetencës ndaj subjektit.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Iirjan CELIBASHI**



Data: 09 Maj 2021  
Nr. 388

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 3930 prot., datë 19.04.2021 përcjellë nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë.